



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.02.2021, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, datë 10.02.2020.
- 2.Shqyrtim i aktit normativ nr. 4, datë 05.02.2021, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021".
- 3.Shqyrtimi i propozimit të ardhur nga Autoriteti i Konkurrencës për ndryshimin e strukturës dhe organikes së këtij institucioni.
- 4.Seancë dëgjimore me kandidatët e vetofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës, i shpallur vakant me vendimin nr.1, datë 21.01.2021.

#### **Marrin pjesë:**

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Rryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

#### **Mungojnë:**

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Korab Lit dhe Xhevit Bushaj.

#### **Të ftuar:**

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Adela Xhemali – Zëvendësministre e Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor

Xhoana Agolli – Drejtoreshë e Menaxhimit të Buxheti

Juliana Latifi – Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës

Vitori Kristo – Drejtoreshë në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse

Taulant Balla – Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Myslim Murrizi – Kryetar i Grupit Parlamentar Demokrat

Edmond Stojku – Kryetar i Grupit Parlamentar Demokraci dhe Drejtësi

Nimet Musaj – Kryetar i Grupit Parlamentar i Pavarur

Zhaklina Peto – Kandidate e vetofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës

Denar Biba – Kandidat i vetofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës

Pajtim Melani – Kandidat i vetofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës

## HAPET MBLEDHJA

**Anastas Angjeli** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Të nderuar kolegë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Sot në rendin e ditës së komisionit kemi për të shqyrtuar disa çështje. Si gjithmonë, çështja e parë është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit tonë, datë 10.02.2021.

Si pikë e dytë është shqyrtim i aktit normativ nr. 4, datë 05.02.2021, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021".

Si pikë e tretë është shqyrtimi i propozimit të ardhur nga Autoriteti i Konkurrencës për ndryshimin e strukturës dhe organikes së këtij institucioni.

Pika e katërt është seanca dëgjimore me kandidatët e vetofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës, i shpallur vakant me vendimin nr.1, datë 21.01.2021.

Të gjithëve ju janë vënë në dispozicion materialet në mënyrë elektronike për të gjitha çështjet.

Para se të fillojmë mbledhjen, duke ju falënderuar të gjithëve, bëjmë verifikimin e prezencës së anëtarëve të komisionit.

Unë jam rezent. Arben Elezi? Antoneta Dhima? Po. Blerina Gjylameti?

**Blerina Gjylameti** – Prezente.

**Anastas Angjeli** – Rolant Xhelilaj? Po.

Reme Lalaj? Po.

*(Nuk dëgjohet.)*

Senida Mesi? Po.

Eljo Hysko? Mungon.

Vullnet Sinaj? Mungon.

Edlira Hyseni? Po.

Krenar Rryçi? Po.

Artur Roshi? Po.

Korab Lita? Nuk e shikoj.

Ylli Shehu? Po.

Suzana Topi? Po.

Meqenëse shumica është, kuorumi është i plotësuar.

Fillojmë me çështjen e parë: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit tonë, datë 10.02.21. A ka ndonjë sugjerim apo vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, në cilësinë e komisionit përgjegjës, akti normativ nr. 4, datë 05.02.2021, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021".

Për të prezantuar aktin normativ janë të pranishëm: ministrja e Financave dhe Ekonomisë, zonja Anila Denaj, zonja Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, zoti Gentian Opre, drejtor i Analizës dhe Programit Buxhetor, si dhe zonja Xhoana Agolli, drejtoreshë e Menaxhimit të Buxhetit. Relator për këtë projekt jam unë.

Fjalën e ka ministrja e Financave dhe Ekonomisë për të prezantuar shkurtimisht këtë akt normativ

Po, zonja Ministre!

**Anila Denaj** – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Arsyet për këtë ndryshim janë të lidhura ngushtësisht me procesin e zgjedhjeve të përgjithshme të datës 25 prill, si një angazhim i qeverisë shqiptare për të përmbushur të gjitha detyrimet e saj, konkretisht lidhet me shpenzimet, të cilat burojnë sidomos nga zbatimi Kodit të ri Zgjedhor të miratuar së fundi.

Në raport me investimet e brendshme, është akomoduar fondi shtesë prej 2,42 miliardë lekësh në programin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për financimin e projektit madhor dhe shumë të rëndësishëm, atë të identifikimit elektronik të zgjedhësve, në kuadër të angazhimit të ndërmarrë për implementimin e tij për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në raport me fondin rezervë të Këshillit të Ministrave, është reflektuar një rritje me një vlerë prej gati 1 miliard lekësh, në kuadër të shpenzimeve eventuale shtesë që mund të burojnë nga implementimi i Kodit të ri Zgjedhor, si dhe përballimi i shpenzimeve të tjera eventuale të qeverisë në kushtet e një viti buxhetor të karakterizuar ende nga pandemia e COVID-19.

Kjo është një shumë, siç e thashë pak më lart, e cila vjen për të respektuar të gjitha detyrimet dhe kërkesat, të cilat, bazuar në shkresën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 20 janar 2021 për kërkesën e këtij fondi si rezultat i procesit të nisur prej tyre, kërkon

një zgjidhje të menjëhershme për t'u akomoduar në mënyrë që ky projekt shumë i rëndësishëm të përfundojë në kohën e duhur dhe optimale.

Unë dua të siguroj se në të gjitha parametrat fiskalë, edhe pse rritja e të ardhurave është reflektuar me masën 3,42 miliardë lekë, të gjithë parametrat kyç makrofiskalë, siç janë deficitin buxhetor dhe borxhi publik, mbeten të pandryshuar.

Faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, zonja Ministre!

Besoj se edhe në diskutimin në mbledhjen e kaluar pati mirëkuptim për këtë çështje. Siç e theksoi ministrja, sot ne po diskutojmë aktin normativ për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2021. Është ndryshimi i parë që bëhet dhe akti i parë normativ që vjen, por arsyet janë madhore, prandaj është bërë me akt normativ, sepse ka të bëjë me sigurimin e të gjitha kushteve për zhvillimin e zgjedhjeve në datën 25 prill. Zgjedhjet parlamentare janë shumë të rëndësishme, në të cilat ne duam të gjithë së bashku, pozitë dhe opozitë, qeveria dhe parlamenti të sigurojmë të gjitha kushtet, me qëllim që të realizohen zgjedhje të lira, demokratike dhe me standarde europiane. Janë zgjedhje, të cilat përcaktojnë vazhdimin e shtetit shqiptar në rrugën e demokracisë dhe integritit të tij. Në këto kushte, ashtu siç vepruam herën e kaluar në mbledhjen e komisionit që garantuam mbështetjen financiare të miratuar në buxhet, edhe tashmë kemi kaluar në shtesën në buxhetin e shtetit të disa fondeve.

Pa dyshim që arsyeja kryesore është e lidhur me zgjedhjet dhe vjen në këtë kohë dhe jo në momentin që diskutuam për buxhetin, sepse marrëveshjet politike midis partive politike për të arritur disa standarde të reja në këto zgjedhje janë arritur më vonë sesa ishte përgatitur projektbuxheti.

Kërkesat u identifikuan më vonë, veprimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë filluar të zhvillohen më vonë sesa projektbuxheti kishte kaluar edhe në qeveri, ishte diskutuar dhe në parlament. Prandaj ne do t'i japim mundësi KQZ-së që të mos i mungojë asnjë mbështetje financiare për të realizuar të gjitha kërkesat që ka ligji "Për zgjedhjet". Është e domosdoshme të vlerësojmë mënyrën sesi Ministria e Financave dhe qeveria kanë vepruar për sigurimin e këtyre fondeve.

Si relator, dua t'ju bëj me dije se të gjitha kushtet kushtetuese për t'u zhvilluar me akt normativ për shkak të emergjencës dhe kushtet e tjera që kërkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë janë plotësuar.

Unë kam një pyetje që ka të bëjë me burimin e sigurimit të këtyre shpenzimeve që shtohen. Në relacion dhe në aktin normativ, po të shikojmë tabelën, vëmë re që burimi i sigurimit janë rritja e të ardhurave në buxhetin e shtetit, është rritja e TVSH-së. Nga analiza

e bërë për ecurinë e të ardhurave të mbledhura nga TVSH-ja, rezulton se në periudhën 2019-2020 të ardhurat e siguruar nga taksa mbi vlerën e shtuar kanë qenë në rënie për shkak edhe të situatës që e dimë të gjithë, të krizës që ka mbërthyer për shkak të pandemisë dhe të pasojave të tërmetit. Me sa duket, kjo krizë është e sigurt që gjatë këtij viti do të jetë prezente, me ndikim edhe në ekonominë tonë. Sa i garantuar është sigurimi i të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar që do të shkojë për mbulimin e këtyre shpenzimeve? A nuk kishte një mundësi tjetër? Kjo ishte pyetja ime si relator. Për problemet e tjera dua t'ju them se, në emër të relatorit ta mbështesim, ta votojmë këtë akt normativ, me qëllim që Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i krijohen të gjitha mundësitë financiare dhe kushtet për zhvillimin normal të veprimtarisë së tij për zgjedhjet e 25 prillit.

Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Po, zoti Roshi.

**Artur Roshi** – Kam një pyetje. A e dinte qeveria se do të ishin zgjedhjet më 25 prill, pse nuk e mori këtë akt normativ që bën sot, pra ta kishte bërë më herët? Mbetëm një herë në javë duke kaluar akte normative.

*(Nuk dëgjohet.)*

**Anastas Angjeli** – Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Hyseni.

**Edlira Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, po e nis nga pyetja e zotit Roshi, duke e qartësuar pak më tepër. Në mos gaboj, projekti për identifikimin elektronik të sjellë sot duhet të jetë pjesë e marrëveshjes politike të 5 qershorit dhe besoj se në atë kohë do të jetë bërë një parashikim i parë për këtë ndryshim të rëndësishëm. Do të doja të dija: pse nuk u arri të bëhej procedura e prokurimit dhe parashikimi i fondit pak a shumë, se është një fond goxha i lartë? Ne buxhetin e kemi kaluar një muaj më përpara. Ata kanë pasur mjaft kohë, mjaft muaj për të krijuar një ide të përafërt, në mos shumë të saktë, lidhur me këtë projekt dhe këtë shumë që të ishte parashikuar që në draftin e parë të buxhetit që miratuam. Pra, të ndërhyhet në buxhet kaq shpejt për një fond kaq të lartë, më duket si një mungesë organizimi të mirë nga ata që duhej ta kishin menduar këtë nevojë më përpara.

Pyetja tjetër: nuk e kisha dëgjimin e mirë, për të kuptuar nëse edhe ju, zoti kryetar, bëtë të njëjtën pyetje që lidhet me të ardhurat. Parashikohet të kemi rreth 28 milionë euro apo 3,4 miliardë lekë nga të ardhurat tatimore nga TVSH-ja. Këtu doja të dija, pra cili është sektori që duket se ka një pritshmëri, po realizon të ardhura, apo ka një rritje më të madhe

sesa ajo që kishim parashikuar para një muaji, kur bëmë parashikimin e parë buxhetor. Pra, cili është ky sektor që mund të japë këtë impakt shtesë dhe të na sigurojë këto të ardhura, se duket nganjëherë sikur shto ujë dhe shto miell, por duhet të dimë se sa objektivë jemi, sa realistë jemi në këto të ardhura që presim të jenë më të larta kaq shpejt.

3. A mendojmë që në këtë moment prioritet fondet kaq të larta për një proces zgjedhor që është i rëndësishëm, por gjithsesi 28 milionë euro janë shumë? A nuk do të ishin më të mira këto para nëse shkonin si mbështetje për sektorët e biznesit që janë me masa shtrënguese, siç janë shërbimet, restorantet, bare apo biznese të tjera që janë në vështirësi dhe do të kishin nevojë për një paketë mbështetëse financiare më shumë se sa të siguronin identifikimin me kartë, që edhe sikur të mos bëhej në këto zgjedhje, mua nuk më duket ndonjë problem i madh? Unë do të doja që prioriteti për këtë ndryshim buxhetor të kishte qenë shëndetësia dhe ekonomia.

Faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Zonja Ministre!

**Anila Denaj** - Faleminderit!

Do të përgjigjem për pjesën e të ardhurave buxhetore në veçanti, por për t’i dhënë përgjigje zotit Roshi dhe arsyes pse ndërhyrjet vijnë shpesh, ne nuk kemi bërë ndërhyrje të shpeshta. Është e saktë që një ndërhyrje në këtë moment kaq herët, siç e tha edhe zonja Hyseni, nuk është alternativa më e mirë e mundshme, pra jam dakord me të, por ne morëm kërkesën formale nga KQZ-ja në datën 20 janar të këtij viti dhe, sigurisht, kemi reaguuar në përputhshmëri të plotë me të gjithë situatën sipas kërkesës që vjen nga KQZ-ja për të akomoduar një vleftë, e cila na erdhi në 20 janar.

Nuk mund të them, zonja Hyseni, se ku mund të akomodohen për ndihmë në sektorin e biznesit, sepse mendojmë se edhe në qasjen që i kemi bërë buxhetit të shtetit, kur kemi diskutuar, nuk kemi lënë pa vëmendje edhe skemën e nxitjes për biznesit në sektorë të ndryshëm për të bërë tashmë krahasimin nëse kjo shumë, e madhe apo e vogël, (nuk më takon mua si Ministri e Financave ta gjykoj), besoj se duhet t’ia bëni këtë pyetje KQZ-së, por është shumë e rëndësishme që këto zgjedhje, këtë identifikim elektronik, ta kenë si pjesë korporale të tyre për të siguruar zgjedhje në atë kuadër të marrëveshjes që është realizuar më parë.

Gjykoj se është një reagim i menjëhershëm i qeverisë për të akomoduar një obligim për zgjedhjet sipas standardeve dhe absolutisht, ndihma për sektorët e shëndetësisë dhe të biznesit nuk mund të lidhet me të dhe absolutisht do t’u jepet vëmendje, nëse është më shumë e nevojshme sipas situatës që mund të përshkallëzohet.

Një element shumë i rëndësishëm në raport me faktin se nga dhe si do të performojë TVSH-ja këtë vit, absolutisht, jam dakord me ju, zoti kryetar, që viti i kaluar nuk është një vit, i cili tregon që rritja e TVSH-së ka ndodhur, pasi ne ishim në një vit të vështirë, megjithatë performanca e TVSH-së në një vit kaq të vështirë nuk u materializuar në skenarin më negativ që ne kishim, kur TVSH-ja ka pasur ulje më të reduktuara edhe se sa gjithë taksat e tjera kombëtare.

Kemi vendosur në fokus të këtij viti rritjen me 10,6% në momentin që kemi diskutuar buxhetin dhe zërin e të ardhurave “miradministrimin fiskal” dhe ekonomia shqiptare për pjesën në të cilën parashikohet si rritja pozitive ekonomike e këtij viti, ashtu edhe performanca brenda kufizimeve të cilat i jetojmë përditë, ne mendojmë që miradministrimi fiskal është një element shumë i rëndësishëm kthese për të mos ngelur peng i këtyre kufizimeve.

Masat për miradministrim fiskal i kemi ndërmarrë me akte juridike dhe po i ndërmarrim me instrumente. E gjithë kjo punë mbështetet dhe do të mbështetet këtë vit mbi këto instrumente për të dhënë atë rezultat të mundshëm të cilin nuk duhet të kufizohet në vleftën e 3,42 miliardë lekëve, por të ketë të ardhura më shumë në vijueshmëri.

Unë nuk e di nëse lashë ndonjë përgjigje pa dhënë, por dua të ndaj pjesën që takon Ministrisë së Financave me pjesën e vleftës apo prokurimit që është një çështje që duhet t'i adresohet një enti tjetër.

Nëse mundem të marr leje, sepse në orën 12 ne kemi mbledhje qeverie, këtu janë zëvendësministrja dhe dy drejtorë të rëndësishëm të MF-së!

Faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, zonja Ministre!

Ju mund të shkoni.

Pyetje tjetër nuk kemi. Në qoftë se nuk ka diçka për të shtuar, më lejoni të them disa përfundime.

**Muslim Murrizi** – Zoti Angjeli, a ka përfaqësues nga KQZ-ja këtu?

**Anastas Angjeli** – Jo, nuk ka, sepse përfaqësuesin e KQZ-së e kishim në mbledhjen e kaluar dhe përfaqësuesi i KQZ-së ia ka drejtuar kërkesën qeverisë, qeveria e ka gjykuar dhe është reflektuar në një akt normativ financiar.

Ne nuk bëjnë analizën e mënyrës se di do të veprojë KQZ-ja për instrumentin që do të përdorë, sepse këto janë çështje që u takojnë procedurave të tyre. Ky akt normativ akordon vetëm fondin që do të vihet në dispozicion të KQZ-së.



**Muslim Murrizi** – Ky akt normativ vjen si pasojë e marrëveshjes së 5 qershorit, ku thuhet tjetër gjë, që identifikimi biometrik merret përsipër të bëhet nga OSBE-ja dhe është 15 milionë euro. Kur e rriti KQZ-ja që nga qershori e deri tani dhe e bënë 20 milionë euro? Këtë marrëveshje e kanë nënshkruar Damiani me Oertin.

**Anastas Angjeli** – I nderuar, zoti Murrizi,

Në dijeninë time KQZ-ja ka bërë të gjitha provat dhe tentativat për të prokuruar këtë çështje. Nuk ka pasur. Ishte një firmë, por nuk arritën të kishin disa firma, por më në fund arritën të sigurojnë një nga kushtet që kanë vënë partitë politike dhe OSBE-ja për zgjedhjet e 25 prillit.

Unë gjykoj që është në të mirën e punës që të plotësohet kjo kërkesë e KQZ-së për standardet që kërkojnë zgjedhjet, të cilat ia kanë vënë edhe partitë politike, edhe marrëveshja, edhe institucionet ndërkombëtare, OSBE-ja dhe ODIHR-i. Natyrisht, çështjet e tjera të teknikës dhe procedurave të zbatimit nuk janë çështjet tona. Ne kemi miratuar kërkesën për fondet mbi bazën e aktit normativ që ka sjellë qeveria, i cili është një akt normativ që ka gjykuar mbi baza reale të kërkesës që ka bërë KQZ-ja dhe që, sipas Kushtetutës, akti normativ hyn në fuqi menjëherë. Tashmë ka filluar procedura dhe tek ne, në komision dhe në Kuvend, votohet ose nuk votohet.

Për të gjitha çështjet e tjera, ju kemi të drejtë t'ia drejtoheni KQZ-së edhe në një seancë pyetjesh për të na informuar më gjerësisht për plotësimin e kushteve të marrëveshjes, përfshi edhe këtë kusht.

Faleminderit!

A ka çështje të tjera?

Duke qenë se burimi i të ardhurave financiare për të plotësuar këtë shpenzim, siç e argumentoi edhe ministrja, do të jetë rritja e të ardhurave dhe veçanërisht të ardhurat nga TVSH-ja, besoj se, siç e kemi theksuar edhe kur u mbledhëm për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2021, organeve fiskale, Ministrisë së Financave dhe dy institucioneve që ajo drejton, u vihen disa detyra me qëllim që të arrijnë këtë objektiv që ka vendosur në buxhetin e vitit 2021, sidomos çështjet që kanë të bëjnë me thjeshtimin e sistemit të taksave për zbatimin me korrektësi të procesit të fiskalizimit që ne kemi miratuar dhe tashmë ka filluar zbatimi i tij, me zgjerimin e bazës së taksave, me thellimin e luftës kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, me përjashtimin nga taksat, si dhe me disa rishikime të taksave dhe të tarifave. Është e rëndësishme, gjithashtu, që të rritet edhe garancia dhe profesionalizmi i kapaciteteve administrative të organeve tatimore.

Nga ana tjetër, është detyrë e tyre dhe e jona bashkë që të forcojmë më tej kuadrin ligjor për të modernizuar dhe thjeshtëzuar sa më shumë sistemin e taksave. Në këto kushte, duke ju ftuar që ta votojmë aktin normativ, jam i gatshëm të filloj votimin.

Kush është dakord me aktin normativ “Për ndryshimin në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021””?

Akti normativ votohet një herë.

Abstenim? 3 abstenime. Kundër? Nuk ka.

Me shumicë votash miratohet aktin normativ “Për ndryshimin në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021””.

Faleminderit!

**Sekretar**  
**Anastas Angjeli**

**Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit**  
**Elvi Prifti**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 17.02.2021, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i propozimit të ardhur nga Autoriteti i Konkurrencës për ndryshimin e strukturës dhe organikes së këtij institucioni.

**Marrin pjesë:**

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Rryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

**Mungojnë:**

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Korab Lit dhe Xhevit Bushaj.

**Të ftuar:**

Juliana Latifi – Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës

Vitori Kristo – Drejtoreshë në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse

**Anastas Angjeli** – Kemi shqyrtimin e propozimit të ardhur nga Autoriteti i Konkurrencës “Mbi ndryshimin e strukturës dhe organikës së institucionit të AK-së”.

Për të prezantuar propozuar janë të pranishëm, kryetarja e AK-së, zonja Juliana Latifi dhe zonja Vitore Kristo, drejtoreshë në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Urdhëroni, zonja Juliana!

**Juliana Latifi** - Faleminderit!

Ne kemi paraqitur një kërkesë pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave ku kërkojmë miratimin e propozimit tonë. Kërkesën e mbështesim në kuadrin ligjor përkatës, si dhe në nevojat e institucionit.

Ky ndryshim i paraqitur nga ana jonë ka ai pikësynim kryesor për afrimin e strukturave të brendshme në realizimin e detyrave, më konkretisht në riorganizimin e institucionit, nga gjashtë drejtori në pesë drejtori. Çështjet e integritit, nga Drejtoria e Integritit i kalojnë Drejtorisë Juridike dhe të Çështjeve Gjyqësore, në zbatimin e planit kombëtar për integrimin europian, kur Drejtorisë Juridike dhe të Çështjeve Gjyqësore bën edhe për afrimin e akteve institucionale, pra të akteve të parashikuara në planin kombëtar, në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku autoriteti i konkurrencës është lider dhe koordinator i kapitullit të 8-të “Politikat e konkurrencës”.

Së dyti, nevoja për të kaluar integrimin pranë kësaj drejtorie lidhet në të njëjtën kohë me mbrojtjen e çështjeve gjyqësore pranë gjykatave, në të gjitha nivelet, pra që nga shkalla e parë deri në shkallë më të lartë. Kjo çështje ka referencën e saj në praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Kjo është arsyeja pse duhet t’i kalojë Drejtorisë Juridike dhe të Çështjeve Gjyqësore.

Nga ana tjetër, për sa i përket komunikimit, numri i punonjësve të kësaj drejtorie në aspektin e komunikimit, që ka të bëjë veçanërisht me atë që ne e quajmë akrobacia e konkurrencës, t’i kalojë drejtorisë që ka një emërtim të ri, pikërisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore, buxheti i saj i komunikimit (*nuk dëgjohet*) një pjesë të detyrave funksionale që ajo ka, por në të njëjtën kohë do të kalojë edhe komunikimin, edhe çështjet që lidhen me marrëdhëniet me jashtë, nga pikëpamja e korrespondencës dhe e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës.

Aktualisht, propozimi nuk ka efekte financiare, pra është një riorganizim i brendshëm i Autoritetit të Konkurrencës.

Ju faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, zonja Juliana!

Kërkesa e Autoritetit të Konkurrencës është shqyrtuar edhe nga Drejtoria e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë. Në informacionin që na kanë dërguar, ata kanë vlerësuar që kërkesa e bërë nga Autoriteti i Konkurrencës për ndryshimin e strukturës është e bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 893/ 2014 “Për Rregullat e procedurat për hartimin dhe strukturimin e brendshëm organizativ në institucionet shtetërore”. Në të njëjtën kohë, edhe në zbatim të nenit 10, pika 1 të ligjit 9584, 17. 7. 2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”

Janë tre elementë të rëndësishëm, që autoriteti kërkon, për të ndryshuar strukturën. Së pari është riorganizimi i brendshëm i saj, me qëllim që t’u përshtatet më mirë kërkesave të kohës, e sidomos procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin European, ku të gjitha institucionet, strukturat dhe legjislacioni shkojnë drejt harmonizimit të plotë me ato të vendeve të Bashkimit European.

Dy elementë të tjerë të rëndësishëm, që plotësojnë kushtet për miratimin e strukturës janë konfirmimi për ndryshimet në strukturë nga Administrata Publike, nga DAP-i, i cila ka dërguar shkresën përkatëse dhe është dakord me këtë ndryshim strukturor, si dhe nga Ministria e Financave, që shikon efektet financiare, e cila ka rënë dakord, për arsye se lëvizjet e brendshme dhe riorganizimi bëhen pa prekur fondet financiare.

Gjithashtu, dua t’ju bëj me dije se Autoriteti i Konkurrencës gjendet përballë një pune voluminoze. Kërkon edhe një shtesë në numrin e punonjësve, por duke qenë se nuk u bë në kohën e duhur, kur u diskutua projektbuxheti, është e pamundur në këtë moment, sepse i kishte fondet brenda Autoritetit të Konkurrencës, nuk kërkonte shtesë fondesh; por meqenëse në këtë moment ka dalë edhe një vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për mosveprim në drejtime tjera të tilla, të shtesës së numrit të punonjësve, gjatë kësaj periudhe do të shqyrtohet në një kohë të dytë, sa të plotësohen kushte të reja, të përmendura më sipër.

Në këto kushte, unë do t’ju ftoj që ta votojmë ndryshimin strukturor, për arsye se është kërkesë legjitime.

Faleminderit!

Kush ka pyetje?

**Artur Roshi** – Një pyetje, kryetar!

**Anastas Angjeli** – Po, po.

**Artur Roshi** – Zonja Latifi, të dëgjova, dhe s’kemi pse të mos jemi pro, aq më tepër kur ti kërkon të kesh një qasje me të nesërmen, po themi, apo me integrimin e Shqipërisë në Bashkimin European, duke futur këtu institucionin tuaj.

Pyetja ime është kjo: me këtë ndryshim që ju kërkoni, a kërkoni edhe shtesë të ardhurash, apo thjesht kërkoni ndryshimin e strukturës? Sepse, ndryshimi i strukturës do të mund të duhet të shoqërohet me fonde, apo jo, me shtesë fondesh?

**Anastas Angjeli** – Nuk ka ndryshim fondesh.

**Artur Roshi** – Mirë që s'ka, e kuptoj që s'ka, por a i duhet? Kjo është pyetja ime.

**Anastas Angjeli** – Jo, jo, nuk ka bërë kërkesë, megjithëse mund ta thotë zonja Juliana, por nuk ka bërë kërkesë për shtesë fondesh, nuk ka ndryshim në buxhet. Edhe kur ka bërë kërkesë për të shtuar numrin e punonjësve, e ka bërë brenda fondeve të veta, paçka se vendimet e fundit nuk lejojnë të bëhen këto lëvizje tani.

Megjithatë, fjala për Julianën.

Hape mikrofonin, Juli, të lutem!

**Juliana Latifi** – Faleminderit, zoti Roshi, për pyetjen! Faleminderit, profesor!

Ashtu siç e tha edhe kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, profesor Angjeli, aktualisht ne kemi marrë miratimin nga Ministria e Financave. Pra, krahas DAP-it, ne kemi marrë miratimin nga Ministria e Financave...

**Anastas Angjeli** – Të lutem, Juli, përsërite edhe një herë, dhe afrohuni te kompjuteri, sepse nuk dëgjoheni! Ngrije një çikë volumin!

**Juliana Latifi** – Aktualisht, propozimi i Autoritetit të Konkurrencës nuk ka efekte financiare. Pra, ne kemi një riorganizim të brendshëm, i cili bën strukturën e sekretariatit, për arsye se Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga dy struktura: Sekretariati dhe Komisioni i Konkurrencës. Pra, ka të bëjë me Sekretariatit, dhe sidomos në këtë situatë pandemie kemi një (*nuk dëgjohet*) të punëve tona, edhe për faktin se kemi një larmi tregjesh, një rritje tregjesh. Kjo është arsyeja pse ne kemi kërkuar këtë riorganizim të brendshëm.

Nuk ka efekte financiare, dhe shkresa e dërguar nga Ministria e Financave evidenton faktin se nuk ka efekte financiare. Ne kërkuam një shtesë, për shkak të rritjes së numrit të hetimeve dhe të vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës, sidomos në tregje që kanë të bëjnë direkt me pandeminë, siç është tregu farmaceutik, me produktet paramjekësore, apo edhe tregu agrourbues, si dhe tregje të tjera, që ne kemi në procedura hetimore, por kuptohet se nuk morëm dakordësi, pavarësisht se kishim fonde, të cilat mund t'i alokonim, siç e tha edhe profesor Angjeli.

Besoj se është e qartë, që ne nuk prekim buxhetin e shtetit, por kemi një riorganizim të brendshëm, sidomos që kanë të bëjnë me çështje të integritetit evropian, të cilat lidhen edhe me vetë pozicionin që ka marrë dhe që ka Autoriteti i Konkurrencës, që është lider i një kapitulli, dhe në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Ju faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, Juliana!

Nuk besoj se ka pyetje ndokush tjetër. Ndryshimi i strukturës, siç u argumentua, është i bazuar në ligj dhe në vendimin e qeverisë, ka marrë mendimin e të dy institucioneve, të cilat janë kompetente për këtë çështje; nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit, por as në buxhetin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kalojmë në votim.

Kush është pro ndryshimit të strukturës së Autoritetit të Konkurrencës?

Faleminderit!

Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Me të gjitha votat e anëtarëve të komisionit, miratohet ndryshimi i strukturës së Autoritetit të Konkurrencës.

Faleminderit!

**Sekretar**  
**Anastas Angjeli**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit**  
**Elvi Prifti**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.02.2021, ora 11.30

**Drejton mbledhjen:**

**Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seance dëgjimore me kandidatet e vetëofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës, shpallur vakant me Vendim Nr. 1, Date 21.1.2021.

1. Zhaklina Peto
2. Denar Biba
3. Pajtim Melani

#### **Marrin pjesë:**

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Suzana Topi, Ylli Shehu, Arben Elezi,

#### **Mungojnë:**

Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Korab Lita, Xhevit Bushaj,

#### **Të ftuar:**

Kryetarët e grupeve parlamentare:

Taulant Balla – Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Myslim Murrizi – Kryetar i Grupit Parlamentar “Demokrat”

Edmond Stojku – Kryetar i Grupit Parlamentar “Demokraci dhe drejtësi”

Nimet Musaj – Kryetar i Grupit Parlamentar “I pavarur”



**Anastas Angjeli** – Kalojmë në çështjen e fundit.

Çështja e fundit ka të bëjë me seancën dëgjimore, që do të bëjmë me kandidatët e vetëofruar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës, shpallur vakant me vendimin nr. 1, datë 21, 01. 2021.

Siç jeni në dijeni, në mbledhjen e datës 21. 01, kemi miratuar shpalljen e vakancës së krijuar si pasojë e dorëheqjes së zotit Helidon Bushati nga pozicioni i anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.

Pas njoftimit të bërë nga shërbimet e Kuvendit, aktualisht janë ofruar për këtë pozicion kandidatët: Zhaklina Peto; Denar Biba; Pajtim Melani.

Natyrisht, të ftuar në këtë mbledhje janë kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zoti Taulant Balla; zoti Myslim Murrizi, kryetar i Grupit Parlamentar “Demokrat”; zoti Edmond Stojku, kryetar i Grupit Parlamentar “Demokraci dhe Drejtësi”, dhe zoti Nimet Musaj, kryetari i Grupit i Grupit Parlamentar “I Pavarur”.

Sot do të zhvillojmë një seancë dëgjimore me secilin kandidat. Kandidatët po i ftoj sipas radhës. Në fund do të kemi edhe procedurën që do të zhvillohet, për të vazhduar procesin e mëtejshëm.

Gjithashtu, dua t’ju bëj me dije se secili kandidat do të paraqesë, do të prezantojë arsyet e kandidimit. Secili do të flasë jo më shumë se dhjetë minuta. Më pas, nga anëtarët e komisionit do të ketë pyetje ose ndonjë plotësim.

Po ashtu, ju bëj me dije që sipas nenit 20 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës, të ndryshuar”, për t’u emëruar në pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës, kandidati duhet të plotësojë këto kritere: të jetë shtetas shqiptar; të ketë vjetërsi në punë profesioni jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet; të jetë prej jo më pak se pesë vjetësh pjesëtar i grupit akademik universitar, të mbajë titull ose gradë shkencore në fushën e ekonomisë apo të drejtësisë, specialiteti: e drejtë civile administrative; të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Sipas nenit 22 të ligjit 9121, datë 28. 7. 2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës, të ndryshuar”, funksioni i anëtarit të konkurrencës, është i papajtueshëm me personat që bëjnë pjesë në organet e larta drejtuese të partive politike, anëtarë të organeve drejtuese të shoqërive tregtare ose persona që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike. Proceduara për zgjedhjen e anëtarit të komisionit zhvillohet nga Kuvendi dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në përputhje me të gjitha rregullat dhe përcaktimet e bëra në nenin nr. 111 të Rregullores së Kuvendit.

Referuar të gjithë kësaj procedure, të gjitha njoftimeve që janë bërë në faqen zyrtare të Kuvendit, propozimi i kandidatit duhet të përmbante fotokopjen e kartës së identitetit, CV-në e ushtruar në çdo faqe nga kandidati, librezë apo vërtetime të tjera të punës që provojnë përmbushjen e kriterit prej 15 vjet punë, vërtetimin nga institucionet e akademike ose dokumentacion që vërteton përmbysjen e pikës C të kriterëve të sipërmendura, vërtetimi që ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore nga puna ose shërbimi civil, vërtetimin e gjendjes gjyqësore deklaratën e konfliktit të interesit, që gjendet bashkëlidhur këtij njoftimi që është bërë dhe formularin e vetdeklarimit në zbatimin e ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhjen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe bashkëlidhur këtij njoftimi. Më në fund , formularin e plotësuar ë zbatim të ligjit nr. 45/215 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i cili gjendet, gjithashtu, bashkëlidhur këtij vendimi.

Natyrisht, Kuvendi, nëpërmjet drejtorisë së monitorimit të institucioneve të pavarura, ka verifikuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga secili anëtar, në përputhje me shpalljen që ka bërë dhe ka konstatuar se, për zonjës Zhaklina Peto, plotëson kriteret sipas nenit 20 të ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës së ndryshuar”, është shtetase shqiptare, ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës Fakulteti i Drejtësisë, dega drejtësi, ka përfunduar master në shkencat civile dhe i plotëson të gjitha kushtet. Për arsye se unë jua kam vënë në dispozicion të gjitha me anë të postës elektronike, nuk dua t’i lexoj të gjitha.

Zoti Denar Biba, gjithashtu është një kandidaturë që i plotëson kriteret tërësisht sipas nenit 20 të ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës, së ndryshuar” dhe zoti Pajtim Melani, plotëson jo tërësisht kriteret sipas nenit 20 të ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës së ndryshuar”, ka vetëm një çështje të procesit të mësimdhënies dhe të gradës shkencore, por që gjatë trajtimit do ta sqarojmë. Në përfundim, me paraqitjen e këtyre kandidaturave, siç dihet kandidatura shkojnë në Kuvend me mbështetjen e 28 deputetëve dhe brenda 3 javë komisioni nga marrja e tyre vendos, nëse kandidaturat i plotësojnë kushtet ligjore për t’i kaluar Parlamentit, për vlerësim, diskutim dhe miratim.

Faleminderit!

Fjala për kandidaturën e parë, zotin Denar Biba.

**Denar Biba** – Përshëndetje, zoti Angjeli!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

**Anastas Angjeli** – Denar, më fal pak!

Besoj që Pajtimi në këto momente, duhet të presë radhën, pastaj vazhdon zoti Pajtim, mbaron zoti Denar, pa qenë prezent prezent në prezantimet e njëri- tjetrit, sipas rregullit.

Faleminderit, zoti Denar!

Fjala për ju, jo më shumë se 10 minuta.

**Denar Biba** – Faleminderit, për mundësinë që më dhatë në këtë dëgjese!

Dua ta nis me një prezantim të shkurtër për veten, jo nga këndvështrimi i atyre elementeve që, për shkak të të qenit deri dje një figurë relativisht publike, më njihni, por për disa elemente të cilat më angazhojnë dhe më bëjnë më të përshtatshëm në lidhje me pozicionin për të cilin unë aplikoj.

Unë jam jurist, tashmë me një eksperiencë prej gati 21 vjetësh. Kam një master në studime europiane nga Universiteti i Athinës, që është një element, vlerësoj, shumë i rëndësishëm në lidhje me aplikimin. Sikundër edhe Juljana e tha, kryetarja aktuale e Autoritetit të Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës është lideri në lidhje me shtyllën 8 të marrëveshjes së asociimit-stabilizimit që ka Shqipëria me Bashkimin Europian. Në këtë pikë, përvoja ime, edukimi im, nga ky këndvështrim në lidhje me studimet europiane, ku një nga elementet e masterit ka qenë ekzaktësisht *acquis communautaire* në atë kohë, sot konsiderohen vetëm *acquis*. Pra, i gjithë legjislacioni i Bashkimit Europian, ku rregulloret e Këshillit janë nga më kryesore, por edhe jurisprudenca e gjykatës së Luksemburgut, më jep një lloj përparësi.

Nga ana tjerët, gjatë gjithë eksperiencës sime, si pranë Gjykatës Kushtetuese, në pozitën e këshilltarit, ashtu edhe pranë Gjykatës së Lartë, e theksoj, pranë kolegjit civil të Gjykatës së Lartë, gjithashtu në pozitën, e këshilltarit, më jep një dimension të të gjykuarit, dimension të cilin kam pasur fatin më pas ta shtrij më tej si eksperiencë edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke qenë në drejtimin të Komisionit, si në pozitën e Kryetarit, edhe të nënkryetarit për shumë vite, edhe si kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik. Janë elemente të së drejtës administrative, të të punuarit kolegjisht, të cilët më ndihmojnë dhe më japin një përparësi.

Në punën dhe në jetën tonë të përditshme ne marri vendime individuale, por është e vështirë të marrësh vendime në kuadër të një komisioni, në kuadër të një grupi kolegjal kolegësh, ku gjithkush prej tyre mund të ketë një interpretim të caktuar të ligjit apo të faktit dhe rrethanave. Eksperienca në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është e jashtëzakonshme, por dua të theksoj në lidhje me pozicionin përkatës, pra me pozicionin e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës edhe pozicionin im si kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik,

nëse ju u riktheheni raporteve vjetore të kryetares së Autoritetit të Konkurrencës, një pjesë e mirë vëzhgimeve të tyre apo e hetimeve, janë në lidhje me prokurimet publike, në këtë pikë, eksperiencia ime, gjithashtu, është favorizuese. Marrëdhënia që unë kam ditur të krijoj në mënyrë të vazhdueshme me kolegët, është një eksperiencë si në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si në Komisionin e Prokurimit Publik, njohja, pse jo personale, e kam pasur pedagoge, zonjën Latifit, besoj se do të më ingranojë menjëherë në këtë detyrë të re.

Nga ana tjerë, duket sikur ka një zhvendosje të karrierës time nga një pozicion relativisht tepër publik, si ai në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me një detyrë të fokusuar te legjislacioni zgjedhor, tek elementë të konkurrencës. Në fakt, metaforikisht, vetëm lloji i miellit ndryshon, sepse gjithë procedurat e arritjes së vendimmarrjes, në fakt është, pothuajse identike. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kemi bërë hetime të vazhdueshme edhe në lidhje me problematika financiare, përmes auditivë tanë, që në këtë rast korrespondojnë me inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, ne kemi audituar financat e partive politike, kemi marrë vendime në lidhje me to, kemi bërë hetime, kemi vendosur penalitete.

Gjatë eksperiencës sime në Komisionin e Prokurimit Publik, gjithashtu, realiteti i hetimit është pothuajse identik. Pra, zhvillohen hetime përmes një ankese, arrihet në konkluzione dhe merren vendime të caktuara në bazë të ligjit.

Dua të theksoj edhe diçka tjetër. Vakanca e çelur në Autoritetin e Konkurrencës është vakancë e një juristi., pra është larguar një jurist. Duke parë këto ditë CV-të e kolegëve, të anëtarëve aktualë të Autoritetit të Konkurrencës, kam vërejtur se, përveç kryetares, zonjës Latifi, gjithë të tjerët janë ekonomistë. Në këtë pikë vlerësoj që duhet me patjetër një jurist atje, siç ka qenë edhe zotit Bushati, i cili është larguar, sepse në thelb vendimmarrja atje është shumë më tepër e ngjashme me atë të një *quasi* gjykate, sesa të një studio ekonomistësh. Ju e dini më mirë se unë, sepse keni bërë edhe ligjin, paçka se viti 2003, kur ky ligj, ligji për mbrojtjen e konkurrencës tashmë duket i largët, por Autoriteti i Konkurrencës bashkë me

Komisionin e Konkurrencës kanë dy struktura, është struktura administrative ajo që bë hetimin dhe është komisioni që merr vendimet. Në strukturën administrative, në sekretariat, aty janë të gjithë ekonomistët dhe juristët, por vendimmarrja në bazë të ligjit sikundër e kërkon edhe ligji për konkurrencën, kërkon një dimension dhe një qasje disi prej juristi. Nuk dua të nënvlerësoj në asnjë lloj rrethane, aq më tepër përpara Komisionit të Ekonomisë, do të ishte fatale nga ana ime të nënvlerësoja punën edhe njohuritë e ekonomistit, por në vendimmarrje, në zbatim me ligjin, është nevojshme të kesh elementë të punës të gjyqësorit, të cilat mua nuk më mungojnë në eksperiencën time. Në këtë pikë,

vlerësoj se një jurist tjetër, plus, bashkë me kryetaren, do të ishte më shumë se sa nevojë, do të ishte domosdoshmëri në këto momente në lidhje me punën e Komisionit të Konkurrencës.

Nuk di ç'të them tjetër. Besoj se 10-minutëshin e respektova.

Është pak e vështirë të flasësh në 10 minuta, aq më tepër të flasësh për veten, është e sikletshme, por, gjithsesi, ndoshta përmes pyetjeve tuaja dalin akoma më mirë elemente të cilat u mundova t'i them.

Ju faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, zoti Denar!

Problemi është që 10-minutëshi është për një prezantim të shkurtër. Ju keni vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe anëtarët e komisionit, edhe pse nuk janë juristë, edhe pse janë ekonomistë, do të dinë të gjykojnë shumë mirë rëndësinë e kandidatëve dhe nevojën që ka Autoriteti i Konkurrencës për kandidatët.

Meqenëse zonja Zhaklina Peto ka njoftuar se nuk do të paraqitet sot në këtë seancë dëgjimore, fjalën ia kaloj kandidatit tjetër, zotit Pajtim Melani.

Ka pyetje për Denarin? Oh, mendova se nuk kishte. Më falni! Atëherë, vijojmë me zonjat Dhima dhe Topi, meqenëse kanë pyetje.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

E falënderoj zotin Biba për prezantimin! Për kohën që ai ka punuar në të gjitha institucionet nuk është një figurë e panjohur edhe për ne anëtarët e komisionit, por është një figurë publike.

Unë kam dy pyetje.

E para, cili është opinioni juaj për mënyrën e funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës?

E dyta, nëse ju do të përzgjidheni në këtë pozicion dhe do të miratoheni nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, çfarë mendoni se do të ofroni ndryshe nga paraardhësi juaj? Për të saktësuar, paraardhësi Bushati nuk ka qenë jurist, por ka qenë...(Nuk dëgjohet.)

Shumë faleminderit!

Jam në pritje të një përgjigjeje nga ana e zotit Biba.

**Denar Biba** – Ju falënderoj për pyetjen!

Vlerësimi im: qëkur vendosa të aplikoj në pozicionin përkatës jam përpjekur të hulumtoj në lidhje me Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri. Përshtypjet janë pozitive, për të mos thënë shumë pozitive. Është bërë një punë shumë e mirë. Website-i është tepër miqësor për përdoruesit, mund të gjesh aty gjithçka: vendimet janë interesante, ka referenca

nga jurisprudenca e Gjykatës së Luksemburgut, ka referenca teorike nga vendimmarrjet nga rregulloret e Këshillit të Bashkimit Europian.

Tri elemente janë, pak a shumë, shtylla që ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” evidenton: ndalimi i karteleve, marrëveshjet e ndaluara; është ideja e shmangies së abuzimit nga pozitat dominuese të një ndërmarrjeje apo të një grupi ndërmarrjesh, si dhe shkrirjet e hetimi i tyre. Nuk gjej në legjislacion asgjë në lidhje me një problematikë që është tepër sensitive në kuadër të legjislacionit për konkurrencën brenda BE-së që lidhet me ndihmën e shtetit. Kur shteti financon ndërmarrje të caktuara, shteti sapo ka ndërhyrë në konkurrencën ndërmjet ndërmarrjeve dhe e ka pamundësuar për ndërmarrje të tjera, të cilat nuk e përfitojnë këtë ndihmë shtetërore që të konkurrojnë lirshëm në atë që ne e kemi treg të gjithëpranuar. Ky është një element që nuk ekziston në ligjin tonë, që është i vitit 2003, i cili ka pasur një *update* tepër domethënës në vitin 2010, duke qenë se edhe në vitin 2010 kanë dalë dy rregullore interesante në kuadër të Këshillit të BE-së, por prej vitit 2010 deri në vitin 2021, pra prej 11 vjetësh, nuk ka më asnjë lloj zhvillimi në kuptim të legjislacionit primar, paçka disa rregullore të autoritetit, të cilat i lexova, m’u dukën interesante dhe koherente në lidhje me zhvillimet në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës. Por shoh që legjislacioni mbetet për t’u përditësuar. Këtu mund të ketë ndoshta një kontribut timin, por e theksoj edhe një herë që ajo, që është bërë deri tani nga Autoriteti i Konkurrencës, është vërtet për t’u vlerësuar. Kam përshtypje shumë të mira nga puna e tyre deri tani.

**Anastas Angjeli** – Faleminderit!

Zonja Suzana, keni edhe ju pyetje.

**Suzana Topi** – Po.

Faleminderit, zoti kryetar!

Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës duhet të jenë sa më objektivë dhe profesionalë. Nëse ju, zoti Biba, do të votoheni nga Kuvendi për të qenë një anëtar i Komisionit të Konkurrencës, a do të udhëhiqeni nga transparencia, barazia, përgjegjshmëria për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg në mënyrë të paanshme?

Faleminderit!

**Denar Biba** – Po, në mënyrë të menjëhershme përgjigjja e gjithkujt dhe e vlerësoj...

**Suzana Topi** – Të paanshme.

**Denar Biba** – Edhe e dikujt, i cili ka të tjera mendime brenda tij, por që nuk i shfaq, një përgjigje formale do të ishte: “Po, me patjetër, në asnjë lloj mënyre, unë nuk do të ndikohem” e kështu me radhë. Në fakt, ajo unë mund t’ju premtoj ju do të jetë një përpjekje. Unë do të përpiqem realisht fort të jem një lexues i mirë dhe korrekt i ligjit. Nga ana tjetër:

“Dy juristë, tre mendje” është një postulat i famshëm mes juristësh. Kështu që këndvështrime të ndryshme në lidhje me ligjin jo domosdoshmërisht nënkuptojnë anësi.

Por ajo që realisht mund t’ju premtoj... Unë do të gënjeja nëse do të thosha: “Unë do të jem absolutisht i paanshëm” dhe realisht do të fyeja, në radhë të parë, inteligjencën time, por edhe inteligjencën tuaj, për të cilën ju vlerësoj të gjithë.

Unë do të bëj të pamundurën, në kuptim të mënyrës se si unë e lexoj ligjin, se si unë i lexoj rrethanat e faktit rast pas rasti. Historia më ka treguar, veçanërisht historia ime personale në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se çdolloj versioni, çdolloj vendimmarrjeje do të bëjë të pakënaqur disa njerëz, të cilët në një mënyrë a në një tjetër mund ta lexojnë edhe keq vendimmarrjen përkatëse. Unë premtoj solemnisht, realisht me sinqeritet, që do të bëj më të mirën time për të qenë një jurist, të cilin besoj se shoqëria e vlerëson dhe më ka vlerësuar deri tani.

Kjo ishte përgjigjja ime e sinqertë.

**Anastas Angjeli** – Faleminderit!

Po, zoti Murrizi, pyetja tjetër.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, zoti Biba!

**Denar Biba** – Përshëndetje!

**Myslim Murrizi** – Unë nuk bëj pjesë te kategoria e individëve që kërkojnë të gjejmë të shenjtin tek ata që zgjidhen nga Kuvendi apo të jesh më i shenjti i 173 mijë punonjësve që punojnë në administratë të shtetit. Unë do të doja të mos jesh shejtan dhe shejtan në sensin e metaforës. Ti vjen nga një përfaqësi politike, ke qenë përfaqësues i Partisë Socialiste në KQZ. A e ndien si ngarkesë te vetja që do të të bjerë të gjykosh subjekte të mëdha, se unë nuk jam dakord fare me atë performancën që ti përshkrove lidhur me punën e Autoritetit të Konkurrencës? Ky i fundit ka zvarritur një çështje hetimore që u ka kushtuar shqiptarëve 400 milionë dollarë në vit: konfliktin e *Bankers Petrol*-it, që i ka bërë synet nga gjuha të pestë ata, edhe Helidoni që drejton qarkun e Shkodrës sot si strateg. Nuk kanë belbëzuar dhe i kanë shtyrë afatet katër herë rresht. Unë jam marrë si deputet duke i dërguar kërkesë këtij autoriteti.

Unë nuk po them që do të vish ti si shpëtimtar, por a je çliruar ndopak nga qenia përfaqësues ekstra i Partisë Socialiste në KQZ dhe ke marrë përsipër të jesh një anëtar i Autoritetit të Konkurrencës që nuk ka anësi politike, megjithëse do të marrësh 28 firmat e deputetëve të PS-së dhe, në njëfarë mënyre, i ardhur prej tyre do të jesh në Autoritetin e Konkurrencës? Sa e ndien veten të çlirët politikisht, kur të kesh konflikte mes qeverisë, siç

thatë ju? Kemi një kompani “*Illyrian Guard*”, që rivalizon të gjitha kompanitë private të shoqërisë fizike të rojeve, që është bërë nga shteti, për të cilën mund të vijë nesër një ankesë nga iks kompani atje dhe të thotë: “Ore, shteti po na i merr të gjitha punët që kemi pasur deri tani, sepse kjo kompani është e shtetit.”. Si do ta gjykosh ti, se shteti është i kësaj maxhorance, dhe ti vjen si përfaqësues i maxhorancës, të paktën kështu ke qenë në KQZ? Pra, a e ndien veten të çliruar nga pesha e përfaqësimit politik që ke pasur gjatë viteve të KQZ-së? Por unë nuk e kam kurrë pritshmërinë që ti do të jesh engjëlli që ne, dhjetë deputetë që jemi këtu, do të të marrim ty në pyetje. Do të jesh si gjithë të tjerët; njeri normal je. Çdo vendim që do të japësh, absolutisht, në të gjithë të tërën e asaj që përbën njeriu ka ndikime. Një nga ne që jemi këtu, a ku di unë, jashtë nesh që jemi këtu, edhe mund të thotë: more, shihe edhe këtë punë që ke ti këtu. Në një konflikt do të kesh ndërhyrje sa të duash. Nuk po them ndërhyrje si Tirja apo Tixhja, çfarë është ajo. Por sa je ti i çlirët nga ngarkesa që ke pasur si përfaqësues i PS-së? Unë uroj që ti të fusësh një frymë tjetër në Autoritetin e Konkurrencës, i cili nuk e ka luajtur rolin që ti, në kortezinë e mosdashjes, t’i bësh pis ata katër anëtarët, ku do të shkosh i pesti. The që kanë bërë mrekulli.

Jo, Denar, jo, nuk kanë bërë mrekulli ata!

Unë kam një fakt dhe një provë konkrete, por edhe dhjetëra biznese të tjera që kanë pasur mundësinë t’i drejtohen këtij Autoriteti; ka qenë një Autoritet për mua inekzistent. Nuk doja të flisja, se nuk isha pjesë, jam zëvendësues në Komisionin e Ekonomisë, por nuk doja të flisja kur iu mbush mendja kryetares, se ka 5 vjet atje, që duhej të ndryshonte strukturën organike, kur e pa të domosdoshme që duhet një strukturë tjetër e me radhë, por duket, për të mos dhënë ngarkesa sikur kam diçka, personalisht a politikisht me ata që janë atje. Unë kam pasur zyrtarisht me ta, si deputet i qarkut të Fierit. *Bankers*-i ushtron aktivitet në qarkun e Fierit me uzinën e Ballshit që la 800 punëtorë rrugëve, dhe kam gjetur 10 palë vendime që shtynjë njëri-tjetrin dhe absolutisht asnjë gjë nuk ka zbatuar nga ato që ka thënë ai autoritet.

**Anastas Angjeli** – Zoti Murrizi, pyetjen, tani që të mbarojmë se në orën 13:00...

**Myslim Murrizi** – Do të doja nga ju miqësisht, për aq sa të njoh, të jesh sa më i shkëputur politikisht. Ndoshta nuk pres ndonjë përgjigje tënden, sepse gjykimi për njerëzit është subjektiv. Të jesh sa më i shkëputur politikisht dhe sa më pak i ndikuar nga ata që i kanë çuar të gjitha buxhetet e shtetit te 3-4 duar në këtë vend, te biznesi. Se sa do t’ia arrish, nuk e di, por hap pas hapi njerëzit e fitojnë pavarësinë, e fitojnë lirinë qoftë profesionalisht, qoftë shpirtërisht.

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, zoti Murrizi!



**Myslim Murrizi** – Unë të uroj suksese dhe, ndër kandidatët e tjerë, megjithëse shoh që dy ikën, besoj që do të jesh i vetmi që do të vish në Kuvend ...

**Denar Biba** – Faleminderit! Të mos e paragjykojmë.

**Myslim Murrizi** – Varet si do të sillesh, se edhe mund të votoj.

**Anastas Angjeli** – Zoti Denar, ju lutem shkurt. ... *(nuk dëgjohet)* që bëri Suzana, komentet ishin ndryshe. Kemi 15 minuta kohë në dispozicion, sepse në orën 13:00 duhet ta kalojmë sistemin në një mbledhje tjetër. Prandaj, ju lutem shumë, të jeni sa më i saktë në këtë përgjigje, në mënyrë që të kemi mundësi t'i japim fjalën edhe kandidatit tjetër.

Fjala për ju, zoti Denar.

**Denar Biba** – Zoti Murrizi më shumë bëri një koment sesa një pyetje. Në këtë pikë e vlerësoj edhe për atë. Nuk mund të pretendoni nga ana ime që të jem njohës i historikut 17 - vjeçar të Autoritetit të Konkurrencës dhe të jap një mendim përfundimtar në lidhje me të gjithë punën gjatë kësaj periudhe. Çdolloj vlerësimi që një individ bën, e bën në sistem reference. Duke njohur institucione të tjera shqiptare, Autoriteti i Konkurrencës m'u duk diçka më mirë. Puna e Autoritetit nga ana ime vlerësohet pozitivisht dhe është gjithmonë në sistem reference në krahasim me institucionet e tjera.

Për sa i përket eksperiencës sime në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku më duhet të theksoj që ...

**Anastas Angjeli** – Më fal, zoti Denar, ju po konkurroni për në Autoritetin e Konkurrencës. Historinë tuaj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve e dimë. Kemi edhe kandidatin tjetër për të dëgjuar, ju lutem!

**Myslim Murrizi** – Unë jam i sqaruar nga Denari.

**Denar Biba** – Unë do të bëj më të mirën time për të ruajtur një emër të mirë si jurist, të cilin besoj se e kam.

Faleminderit!

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, zoti Denar për prezantimin tuaj! Ne i urojmë suksese çdo kandidati që paraqitet, por që duhet të plotësojë të gjitha ato kushte, si dhe 28 firmat që tha zoti Murrizi, i cili edhe ai është i gatshëm të firmosë.

Fjalën e ka zoti Pajtim Melani për të bërë prezantimin.

**Myslim Murrizi** – Për Denarin do të firmos, jo për të tjerët, kryetar.

**Anastas Angjeli** – Mos e demoralizo Pajtimin.

Zoti Denar, jeni i lutur të largoheni. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Zoti Pajtim, mirë se erdhët! Fjala për ju është jo më shumë se 10 minuta.

**Pajtim Melani** – Faleminderit!

Ju kam ndjekur në këtë mbledhje të gjatë dhe do ju marr jo më shumë se 5 minuta.

Së pari, zoti kryetar, duke ruajtur konsideratat më të larta për ju dhe anëtarët e tjerë të komisionit, mendoj se ka një lapsus shumë të rëndë të Shërbimit të Monitorimit. Unë jam zotërues i një masteri për administrim- biznesi, master shkencor në ekonomiks, po bëj doktoraturën për Ekonomiks dhe tema është pikërisht për konkurrencën.

**Anastas Angjeli** – Pajtim, ke probleme me mikrofonin dhe nuk dëgjohesh.

**Pajtim Melani** – Duke ruajtur konsideratat më të larta për ju dhe të gjithë anëtarët e komisionit, zoti kryetar, doja të korrektoja atë çfarë ju thatë nga Shërbimi i Monitorimit. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës kërkon titull ose gradë shkencore dhe unë sigurisht që kam depozituar masterin tim në administrim biznes, diplomën bachelor dhe master shkencor në ekonomiks, ndërkohë që po bëj doktoraturën. Besoj se jam ndër të rrallët që po bëj doktoraturë me temë për konkurrencën. Sot që flasim jam ... *(nuk dëgjohet)*

Unë jam bashkautor i ligjit të amenduar, që zotëria po mendohej ta kujtonte, dhe e njoh ligjin sepse kam punuar 11 vjet në Autoritetin e Konkurrencës si Drejtor i Mbikëqyrjes së Tregut, me tre kolonat e ligjit, marrëdhëniet e ndaluara, kontrollin e përqendrimeve dhe abuzime me pozitat dominuese, plus avokacinë e konkurrencës... *(nuk dëgjohet)* Nga kjo pikëpamje nuk e di se si mundet të ketë këtë konkluzion, por besoj se ju mund ta korrigjoni në atë pjesë.

Unë e njoh Autoritetin e Konkurrencës që nga themeli. Punoj atje prej më shumë se 12 vjetësh. Ndërkohë, edhe pjesa tjetër e eksperiencës, qoftë në AMF, qoftë në Rregullatorin AKEP, ka qenë e lidhur me konkurrencën me një bashkëpunim Rregullator - Autoritet Konkurrence shumë të mirë.

Ajo çfarë unë do të doja të ndryshonte në të gjithë këtë historinë e zbatimit të ligjit të politikës së konkurrencës do të ishte marrja me çështjet e rëndësishme, që prekin sot realitetin ekonomik, marrja me dominancën, me tregjet e rregulluara në energji në gaz, në sektorin financiar ... *(nuk dëgjohet)*, që po ndodhin sidomos në tregjet që janë sensitive për konsumatorin dhe së fundi rritja e burokracisë së ligjit të konkurrencës.

Ju si Kuvend e keni ngritur disa herë në rezolutë për Autoritetin e Konkurrencës që ministritë, ajo që ngriti zoti Murrizi, dhe qeveria duhet të marrin opinionin e Autoritetit të Konkurrencës për ligje, akte ligjore dhe nënligjore që prekin veprimtarinë e konkurrencës. Ne kemi kundërshtuar në atë kohë vendimin e qeverisë për naftën D2, e cila i jepte ekskluzivitet vetëm ARMO-s dhe kemi pasur guximin profesional që ta kundërshtojmë vendimin e qeverisë së kohës dhe të hapim tregun për të gjithë operatorët. Një propozim tjetër do të ishte ndryshimi i ligjit, i cili tashmë sigurisht ka shumë pjesë këtu përafuar me

*acqui communautaire*, dhe sidomos marrja e ndihmës shtetërore. Unë nuk dua ta paragjykoj procesin dhe kam besimin e plotë që ju do dini të zgjidhni midis një personi që ka më shumë se 15 vjet që merret me fushën e konkurrencës dhe dikujt tjetër. Me të tjerët nuk dua të merrem sepse u kuptua qartë edhe nga pyetjet që në çfarë fushe janë. Unë mendoj që edhe nëse nuk do të jem unë në atë pozicion, ndihma shtetërore duhet të kalojë tek Autoriteti i Konkurrencës, ju si Komisioni i Ekonomisë e keni mundësinë, sepse në Ministrinë e Ekonomisë ka degraduar në një sektor shumë të vogël, ndërkohë që shumica e vendeve anëtare të BE-së e kanë strukturën e ndihmës shtetërore pranë Komisionit të Konkurrencës, ashtu siç e ka Italia. Madje atje ka edhe funksione të tjera, siç është ajo e konfliktit të interesit, që në fakt është një strukturë po aq e rëndësishme.

Faleminderit!

Besoj se nuk jam zgjatur prezantim.

**Anastas Angjeli** – Faleminderit, Pajtim!

Dua të sqaroj edhe një herë që ishte kjo arsyeja, që unë e përmenda, që ti të prononcoheshe për përfundimin që ka arritur Shërbimi i Monitorimit në Kuvendin e Shqipërisë. Ata kanë shpallur disa kritere të bazuara në ligj. Gjykimi i tyre ishte që doktoratura juaj është në proces dhe është e papërfunduar. Unë bashkë me Shërbimin do ta shikojmë sugjerimin tuaj, do ta ballafaqojmë me ligjin, por sugjerimi i Shërbimit është i bazuar në faktin që ju nuk e keni përfunduar doktoraturën dhe kushti është që të ketë gradën shkencore “doktor”.

**Pajtim Melani** – Më fal, zoti kryetar!

Ligjin mund ta lexojmë secili nga ne. Thuhet “titull apo gradë shkencore”. Ju sot keni anëtarë të komisionit të nderuar që nuk kanë as njërën, as tjetrën, por ky është problem tjetër.

**Anastas Angjeli** - Pajtim, nuk është në nderin tënd dhe as në të drejtën tënde të gjykosh që anëtarët e komisionit kanë tituj apo gradë shkencore. Ata janë këtu me votën e popullit, të votuar, të zgjedhur.

**Pajtim Melani** – Unë flas për Autoritetin e Konkurrencës, zoti kryetar.

**Anastas Angjeli** - Ju lutem, prezantimi juaj mbaroi!

Kush ka pyetje? Nuk ka pyetje.

Faleminderit!

Antoneta, ke pyetje?

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zotin Melani! Në fakt nuk është hera e parë që ai vjen në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, por sot vjen ...

**Anastas Angjeli** - Antoneta, pyetjen direkt, se nuk kemi kohë.

**Antoneta Dhima** – Cilat janë drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës? Së dyti, në opinionin tuaj, cilat tregjet me impakt të drejtpërdrejtë të konsumatori shqiptar dhe nëse ju keni informacion, çfarë është duke hetuar aktualisht Autoriteti i Konkurrencës?

Faleminderit!

**Pajtim Melani** – Faleminderit!

Ju kërkoj ndjesë, nuk e kisha për ju, por për Komisionin e Konkurrencës.

**Anastas Angjeli** – Nuk ka problem!

**Pajtim Melani** – Unë kam konsideratat maksimale dhe dua që të vazhdoj ta ruaj këtë respekt.

**Anastas Angjeli** – Ishte keqkuptim që u sqarua. Ju lutem përgjigjuni pyetjes.

**Pajtim Melani** - Tri kolonat e ligji janë luftimi i karteleve, abuzimi me pozitat dominuese dhe përqendrimet. Aktualisht, Autoriteti i ka shtrirë hetimet në fushën e barnave, sidomos nga situata e COVID-it, për shkak se çmimet e një sërë produktesh janë rritur; në fushën e telekomunikacionit për shkak se ekziston mundësia që të ketë një sipërmarrje me abuzim me pozitën dominuese; në tregun e karburanteve përfshirë edhe gazin e lëngshëm, të cilat janë hetime për të cilat unë do të sugjeroja që të kishim një ritëm shpejtësie hetimi dhe raportimi sa më të shpejtë. Besoj se është e mundur që të realizohet.

**Anastas Angjeli** – Të nderuar kolegë, këtu përfunduar dy dëgjesa. Siç e thashë në krye të fjalës, një kandidate që kishte paraqitur dokumentacionin nuk u paraqit, zonja Zhaklina Peto, por u paraqitën dy kandidatë, zoti Denar Biba dhe zoti Pajtim Melani.

Në vazhdim të procedurave, sipas ligjit do të arrijmë në përfundimin për të dërguar në parlament atë kandidaturë që plotëson kushtet dhe merr 28 firma për t'u paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë.

Në postën tuaj elektronike do të keni njoftimin për mbledhjen e ardhshme, e cila do të jenë nesër në orën 10:00, për arsye se ka një marrëveshje që është me urgjencë. Në të njëjtën kohë, gjatë javës së ardhshme, do të zhvillojmë dy ose tri mbledhje të tjera, për arsye se janë një sërë materialesh të paraqitura, të cilat duhet që të kapin afatin e miratimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

Ju uroj një ditë të mbarë të gjithëve dhe faleminderit!

Faleminderit, Pajtim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretar  
Anastas Angjeli**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve  
Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit  
Elvi Prifti**